



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 102-Dhjetor 2011 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>



Pamje nga nënkalimi (Astrazub), rruga (Rud), ura (Mirushë-Gurbardh)



Përmbajtja

Inspektohen punimet e nënkalimit në Astrazup.....	2
Kryetari Kilaj takoi protestuesit nga Bellanica	3
Thatësira shton kërkesat për ujë të pijes.....	4
Malisheva, komunë e qetë dhe stabile	5
FSK mban ligjërata për rrezikun nga mjetet piroteknike	6
Kryetari Kilaj priti në takim një delegacion nga Bellanica	7
USAID prezantoi para bizneseve indeksin e konkurrencës.....	8
Komuna dhe USAID përruan nënkalimin në Astrazup dhe renovimin e sallës së KK-së.....	9
Përfundon asfaltimi i rrugës në fshatin Rud	10
OSBE mbështet Zyrën për Informim Publik	11
Prezantohen projektet e realizuara dhe prioritetet për vitin 2012	12
Falënderohen gazetarët për pasqyrimin e ngjarjeve nga Malisheva.....	14
DKRS shpalli më të mirët për vitin 2011	16
U mbajt mbledhja e XXII-të e Kuvendit të Komunës.....	17

Inspektohen punimet e nënkalimit në Astrazup



Malishevë, 2 dhjetor



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, me qëllim të njohjes për nga afër me punimet në nënkalimin në Astrazup, sot ka vizituar këtë fshat, ku ka inspektuar punimet, të cilat kanë hyrë në fazën përfundimtare dhe pritet që brenda disa ditëve ky nënkalim të futet nën funksion.

Kryetari Kilaj, u nda i kënaqur me punimet, ku aktualisht është duke u shtruar në asfalt pjesa e dëmtuar e rrugës magjistrale, me rastin e ndërtimit të nënkalimit, ndërsa punëkryesi u zotua se brenda afatit do të përfundojnë punimet.

Ndërtimi i nënkalimit, ka hyrë në fazën përfundimtare dhe kanë mbetur edhe disa punë teknike deri në përfundimin e tij.

Ky projekt, është mirëpritur nga banorët e këtij vendbanimi, pasi fëmijët kanë qenë vazhdimisht të rrezikuar në trafik gjatë shkuarjes në shkollë, ndërsa nga tani jeta e tyre është më e sigurt, pasi nuk kanë nevojë të kalojnë nëpër rrugën magjistrale, Prishtinë-Malishevë-Rahovec.

Projekti është donacion i Komunës dhe USAID-it.

Kryetari Kilaj takoi protestuesit nga Bellanica

Malishevë, 2 dhjetor



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, ka pritur sot një delegacion nga Bellanica, të cilët po protestojnë me pretekst të kompensimit të pronave të tyre, tashmë të privatizuara nga AKM-ja, ku edhe është njoftuar me problemet e tyre.

Ky delegacion, ka sqaruar para kryetarit të komunës problemet që ata kanë për rikthimin e pronave të marra në ish Jugosllavi, e ta cilat janë privatizuar vite më parë, si pronësi e ndërmarrjes bujqësore “Mirusha”, ndërsa tani nëpër ato prona ka filluar ndërtimi i autostradës. Bellanicasit po kërkojnë që kompensimi t’ju bëhet atyre, pasi pretendojnë se kanë qenë pronë e tyre. Ata kërkojnë që komuna të ju kthejë pronat.

Kryetari Kilaj, pasi është njoftuar me këto probleme, i ka sqaruar për kompetencat e komunës në këtë rast dhe të kompetencave të kryetarit dhe i ka sugjeruar që të ndjekin procedurat ligjore. “Komuna, as nuk merr as nuk jep tokë, por as privatizimin nuk e bën komuna, këtë e ka bërë AKM-ja”, ka sqaruar z. Kilaj.

“Unë nuk kam kompetenca për ti kthyer pronat, por këtë e bën gjykata”, i ka thënë Kilaj para banorëve të Bellanicës. “Ndiqni procedurat e rregullta ligjore”, ka sugjeruar Kilaj, përderisa ka sqaruar se ndërtimi i autostradës nuk bën të pengohet.

Delegacioni, si pjesë e protestuesve, u shprehë se, pavarësisht tentimit të pengimit të punimeve në atë pjesë, ata nuk janë kundër ndërtimit të autostradës, por kërkojnë që të bëhen pronar të pronave dhe të kompensohen. Ata po ashtu kanë sqaruar se çështja e pronave, është në gjykatë.

Me kërkesë të banorëve të fshatit Bellanicë, kryetari Kilaj, do të mbaj edhe një takim në orët e mbrëmjes së sotme (e premtë), në Bellanicë.

Thatësira shton kërkesat për ujë të pijes

Malishevë, 5 dhjetor



Janë rritur kërkesat për furnizim me ujë për pije sidomos në fshatrat Bubavec dhe Drenoc, për shkak të thatësisë së madhe nga mungesa e reshjeve atmosferike, kështu është bërë e ditur në mbledhjen e rregullt të qeverisë komunale në Malishevë, e cila mbahet çdo të hënë dhe kryesohet nga kryetari i komunës, z.Isni Kilaj.

Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Halit Zogaj, ka bërë të ditur se, “janë rritur kërkesat për furnizim me ujë për pije, sidomos në fshatrat Bubavec dhe Drenoc, ndërsa deri më tani, si drejtori u janë përgjigjur të gjitha kërkesave, por numri po rritet në vazhdimësi”. “Këto dy fshatra, do të jenë prioritet i komunës për zgjidhjen e problemit të ujit”, ka thënë kryetari Kilaj, i cili po ashtu bëri të ditur se janë bërë shumë hulumtime për gjetjen e ujit, sepse sipas rezultateve të deritashme ajo zonë ka mungesë të burimeve të ujit.

Përndryshe, në këtë mbledhje, edhe drejtorët tjerë kanë raportuar për punët e drejtorive dhe angazhimin e tyre për përfundimin e planeve, deri në fund të vitit.

Malisheva, komunë e qetë dhe stabile

Malishevë, 8 dhjetor

Situata e sigurisë së përgjithshme në komunën e Malishevës, është e qetë dhe stabile, dhe pa tendencë të prishjes së kësaj situatë. Kështu ka vlerësuar Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), në mbledhjen e saj të radhës, të mbajtur sot.

“Siguria e përgjithshme në komunën e Malishevës, është e qetë dhe stabile”, ka vlerësuar drejtori i drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Halit Zogaj, i cili edhe udhëheq KKSBB-në. “Shqetësuese vazhdon të mbetet siguria në trafik, mungesa e parkingjeve në qytetin e Malishevës, si dhe vetëvrasjet”, ka thënë drejtori Zogaj.

Ndërsa, komandanti i stacionit policor në Malishevës, togeri Bekim Begaj, ka raportuar për situatën e përgjithshme të sigurisë, i cili po ashtu e ka vlerësuar të qetë. “Gjatë muajit të kaluar janë shënuar dy raste të vdekjeve, njëra vetëvrasje dhe tjetra vdekje aksidentale në punë”, raportoi Begaj.



Sipas komandantit Begaj, gjatë muajit të kaluar ka pasur dy raste të tentim vetëvrasjeve dhe 17 aksidente në trafik, që do të thotë sa ka rënie të rasteve në këto dy fusha të sigurisë, përderisa janë shënuar edhe disa incidente, kryesisht në mes të rinjve.

“Aktuale gjatë ditëve të fundit, janë edhe protestat e banorëve të fshatit Bellanicë, të cilët kanë protestuar për disa ditë me radhë, por protestat kanë qenë të qeta, ndërsa tri ditë është bllokuar rruga, nga 10 deri në 20 minuta në ditë”, tha Begaj. Ai po ashtu bëri të ditur se do të shtohen aktivitetet policore gjatë këtij muaji, kryesisht në trafik, për shkak të festave të fundvitit dhe rritjes së numrit të automjeteve në trafik.

Në këtë takim u tha edhe se gjatë këtij muaji, do të mbahen trajnime në shkolla në lidhje me rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike.

Edhe Bashkësia Islame në Malishevë e konsideron të qetë situatën e sigurisë së përgjithshme. “Situata e sigurisë në Malishevë, është shumë më e mirë se në komuna tjera”, tha mulla Xhevat Kryeziu, nga Bashkësia Islame e Malishevës. Ai po ashtu njoftoi edhe për arritjen e disa pajtimeve të ngatërresave në këtë komunë.

FSK mban ligjërata për rrezikun nga mjetet piroteknike

Malishevë, 12 dhjetor

Sot, në Qendrën e Kompetencës, pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), para nxënësve të kësaj shkolle të mesme





profesionale, kanë mbajtur ligjërata mbi rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike.

Kjo ligjëratë është organizuar nga Ekipi Veprues për Siguri në Bashkësi (EVSB) në Malishevë në bashkëpunim me FSK-në, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe ICITAP-in, ndërsa qëllimi i këtyre ligjëratave është, vetëdijesimi i qytetarëve, në veçanti i të rinjve për rrezikun e përdorimit të këtyre mjeteve dhe pasojat e tyre.

Ky është edhe një aktivitet që organizon EVSB, roli i së cilës është siguria në bashkësi, ndërsa deri më tani këto ekipe në Malishevë kanë organizuar disa aktivitete.

Kryetari Kilaj priti në takim një delegacion nga Bellanica

Malishevë, 12 dhjetor

Kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, sot në orët e pasdites, ka pritur në takim një delegacion nga fshati Bellanicë për të diskutuar në lidhje kontestimin nga ana e tyre të pronave nëpër të cilat do të kalon autostrada.

Të pranishëm në këtë takim, ishin edhe deputetët nga komuna e Malishevës në Parlamentin e Republikës së Kosovës, z. Halit Krasniqi (PDK), dhe z. Sali Morina (LDK). I ftuar nga banorët e Bellanicës kishte qenë edhe z. Visar Ymeri (VV), i cili nuk ishte i pranishëm.

Me këtë rast është diskutuar “problemi” që është paraqitur me një pjesë të fshatit Bellanicë, në të cilën do të kalojë autostrada. Kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj ka sqaruar me procedurat e privatizimit, dhe të dhënat që u janë përcjell atëherë AKM-së. “ Në evidencat tona, figurojnë të dhënat vetëm nga viti 1959, dhe bazuar në këto shënime, autorësia e pronësisë nuk ekziston ”, është shprehur midis tjerash z. Kilaj, duke ofruar mundësi, që pretenduesit që janë pronarë të këtyre tokave, të kenë qasje në dokumentet kadastrale. Të pranishëm në këtë takim ishin edhe drejtori i gjeodezisë z. Nuhi Shala me bashkëpunëtor. Lidhur me këtë, delegacioni në fjalë, i cili kryesohet nga kryetari fshatit z. Isuf Sertolli, është shprehur mirënjohës me pritjen dhe sqarimin, ndërkohë që edhe deputetët Halit Krasniqi



e Sali Morina, kanë njoftuar se këtë çështje e kanë ngritur në nivel të Qeverisë së Kosovës, prej nga pritet një përgjigje nga ana e tyre.

USAID prezantoi para bizneseve indeksin e konkurrencës

Malishevë, 13 dhjetor



USAID-i, sot para pronarëve të bizneseve të Malishevës, ka prezantuar indeksin e konkurrencës në komunat e Kosovës, në kuadër të programit të saj, për përmirësimin e mjedisit afarist. Ky katim kishte për qëllim përmirësimin e mjedisit ligjor dhe rregullativ, në mënyrë që të bëhet e lehtë nisja, funksionimi dhe zgjerimi i biznesit.

Paraprakisht, nënkryetari i komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, ka falënderuar USAID-in, për mbështetjen e dhënë në shumë fusha, me qëllim të zhvillimit të përgjithshëm. Ndërsa duke folur për lehtësirat nga ana e komunës, z. Mazreku tha se “është hapur zyra e regjistrimit të bizneseve, përmes së cilës, janë krijuar kushte për shërbime të shpejta për regjistrimin e biznesit, pastaj jemi në përfundim e sipër të ndërtimit Qendrës së Biznesit, me qëllim të ofrimit të shërbimeve më të mira dhe e cila ndikon në zhvillimin e përgjithshëm”.

Ndërsa prezantimin e indeksit të konkurrencës në komuna e bëri koordinatori komunal në Prizren, i USAID-it, z. Haxhi Seferqaj, sipas të cilit, komunat e regjionit të Prizrenit, renditen më së miri në këtë fushë, e ku përfshihet edhe komuna e Malishevës.

Për shërbimet ndaj bizneseve ka folur zyrtari komunal z.Halil Shurdhaj, më pas është hapur debati, ku vet biznesmenët kanë parashtruar problemet dhe kërkesa në adresë të institucioneve, me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për zhvillimin e aktivitetet të tyre.



Komuna dhe USAID përuruan nënkalimin në Astrazup dhe renovimin e sallës së KK-së

Malishevë, 14 dhjetor



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj dhe drejtoresha e programit DEMI (program i USAID), znj. Ginka Kapitanova, sot kanë bërë prerjen e shiritit përurues të dy projekte të realizuara në Komunën e Malishevës, nënkalimin në fshatin Astrazup dhe renovimin e sallës së mbledhjeve të Kuvendit Komunal poashtu në Malishevë.

Me këtë rast kryetari Kilaj, ka falënderuar USAID-in, për këto investime në komunën që ai drejton, përmes të cilave, krijohet siguri më e madhe, në veçanti për fëmijët e fshatit Astrazup si dhe kushte më të mira për punën e Asamblesë Komunale.

“Sot bëmë inaugurimin e këtyre dy projekteve shumë të rëndësishme për komunën e Malishevës, renovimin e Asamblesë Komunale dhe nënkalimin në Astrazup, që u dedikohet nxënësve. Sot USAID, ka shpëtuar jetë njerëzish në këtë fshat” ka thënë midis tjerash z. Kilaj, duke i konsideruar projektet me vlera të përjetshme. Njëkohësisht ka falënderuar USAID-in dhe DEMI-n për realizimin e këtyre dy projekteve.





Ginka Kapitanova, drejtoreshë e programit DEMI, në USAID, e ka quajtur komunën e Malishevës, si partnere dhe bashkëpunëtore në realizimin e këtyre projekteve, pasi pa ndihmën dhe idetë e komunës, as këto projekte nuk do të mund të realizoheshin.

“Kjo është ditë e veçantë për USAID me rastin e inaugurimit të këtyre projekteve; falënderoi kryetarin dhe ekipin tij për realizimin me sukses të këtyre dy investimeve. Ky nën kalim, është projekt për fëmijët e këtij fshati, ndërsa renovimi i Asamblesë Komunale, do t’i mundësoj asamblistëve kushte me të mira pune. I falënderoj të gjithë që kanë kontribuar në këtë projekt”, tha drejtoresha Kapitanova.

Projektet janë pjesë e programit të USAID-it, Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive (DEMI) dhe janë realizuar në bashkëpunim me komunën e Malishevës.

Ndërtimi i nënkalimit në Astrazup, ka kushtuar 46, 330 dollarë, ku USAID-i ka kontribuar me 37, 064 dollarë, ndërsa komuna e Malishevës me, 10, 748.56 dollarë. Për renovimin e sallës së Asamblesë Komunale, janë investuar 26,682.59 dollarë, USAID-i 21,306 dollarë, komuna 5,375.59 dollarë.

Përfundon asfaltimi i rrugës në fshatin Rud

Malishevë, 16 dhjetor



Komuna e Malishevës, në bashkëfinancim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), kanë përfunduar asfaltimin e rrugës 1 350 metra në fshatin Rud. Ndërtimi i kësaj rruge, është pjesë e angazhimeve për krijimin e kushteve më të



mira për jetë dhe mirëqenie të qytetarëve të Komunës së Malishevës.

Kjo rrugë, ishte kërkesë e kahershme e banorëve të fshatit Rud dhe në të njëjtën kohë prioritet i qeverisë komunale të Malishevës dhe të komunës z. Isni Kilaj, i cili u kishte premtuar këtyre banorëve ndërtimin e rrugës për këtë fshat të thellë.

Problem më të madh në qarkullim (lëvizje), kanë pasur nxënësit e këtij fshati, të cilët vijnë në mësim në shkollën e fshatit Panorç.

Rruga në fshatin Rud, është e gjatë 1350 metra, ndërsa shuma për ndërtimin e saj ku përfshihet zgjerimi dhe asfaltimi, është 86,662.50 €. Komuna ka investuar 46,662.50 €, ndërsa MAPL-ja 40,000 €.

Realizimi i projektit është bërë nga kompania “Jehona” SHPK.

OSBE mbështet Zyrën për Informim Publik

Malishevë, 20 dhjetor

Zyra rajonale e OSBE-së në Prizren, me mjete konkretizuese, ka mbështetur Zyrën për Informim Publik në Komunën e Malishevës. Kjo mbështetje është bërë në kuadër të projektit të OSBE-së, në lidhje me Informimin Publik dhe Raportet me Media.

OSBE, i ka dhuruar Zyrës për Informim Publik (ZIP) në Malishevë një foto kamerë digjitale dhe një diktafon profesional.

Këto mjete janë ndarë, pas një trajnimit të tre ditorëve dhe punëtorëve dy ditore, të zyrtarëve për informim, organizuar nga OSBE, me temën “Informimi Publik dhe Raportet me Media”.

Mbahet dëgjimi i dytë publik me qytetarët



Prezantohen projektet e realizuara dhe prioritetet për vitin 2012

Malishevë, 22 dhjetor



Kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka mbajtur sot takimin e dytë (brenda këtij viti), me qytetarë, ku është diskutuar për shumë çështje, ndërkohë është bërë edhe prezantimi i projekteve të realizuara, atyre që janë në realizim, dhe prioriteteve për vitin 2012.

Të ftuar në këtë takim, ishin edhe kryetarët e fshatrave të komunës së Malishevës. Me këtë rast kryetari Kilaj i ka përshëndetur ata për zgjedhjen në përfaqësim të fshatrave dhe u ka uruar punë të mbarë, ndërkohë ka falënderuar për punën e bërë edhe paraardhësit e tyre.

“Unë ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim, dhe iu them se takime të tilla kur ne organizojmë, janë në interes të të gjithë neve, në radhë të parë si qytetarë të komunës së Malishevës, dhe mendoj që prania juaj është e domosdoshme dhe e mirëseardhur”, kështu tha midis tjerash kryetari i komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, duke iu adresuar të pranishmëve.

Me këtë rast përveç projekteve të këtij viti, që janë prezantuar edhe me video-projektor (të cilat do ti bashkëngjesim në vijim të këtij lajmi), dhe planifikimeve për vitin 2012, përgjatë takimit, kryetari ka dëgjuar edhe shqetësimet, konkretisht prioritetet që kanë paraqitur kryesuesit e fshatrave, për vendbanimet prej nga vinin.

Në mesin e tyre kishte kërkesa për kanalizime, mandej problem paraqitej tensioni i lartë i energjisë elektrike, mirëmbajtje të rrugëve, sidomos atyre të vendeve të thella, disa rrethoja të shkollave, ndërtim shkollash, trotuare, etj. , shumica e të cilave janë të planifikuara për realizim në vitin 2012.

Në vijim lista e projekteve, që janë përfunduar, realizuar dhe në realizim e sipër:



DISA NGA PROJKETET E VITIT 2011:

1. Qendra e Kompetencës/ shkollë profesionale – Malishevë;
2. Shtëpia e Kulturës “Tahir Sinani” - Malishevë;
3. Palestra e Sporteve- Malishevë;
4. Shkolla (fillore)- Banjë;
5. Shkolla fillore/ ANEKSI, në Marali;
6. Renovimi i shkollës në Dragobil, Gurbardh, Guncat, Temeçinë;
7. Trotuaret në Lumishtë, Carrallukë, Dragobil, Kijevë;
8. Rrjete kanalizimi në Gurbardh, Shkozë, Plloqicë, Balincë;
9. Kolektori i ujërave të zeza;
10. Parku i Gjellbër, në Mirushë;
11. Qendra e Biznesit;
12. Shtrati i lumit “Mirusha” ;
13. Mirëmbajtja e rrugëve;
14. Asfaltimi i rrugëve në Pagarushë & Malishevë;
15. Fusha e futbollit;
16. Renovimi i Sallës së Asamblesë;
17. Ndërtimi i nënkalimit në Astrazub;
18. Renovimi i kullave në Llapçevë e Banjë;
19. Hartimi projektit për rrugët Malishevë, Burim dhe Gurbardh;
20. Riparimi i rrugëve Panorc- Rud dhe Mirushë;
21. Ndërtimi i kanalizimit në Banjë-Malishevë dhe Mirushë-Lumishtë;
22. Ndërtimi i kanalizimit fekale në Banjë, lagjet Buzhala e Shala;
23. Furnizim me rëntgen për QKMF-në e qytetit;
24. Çmontimi dhe transporti i fushës së sporteve nga Prizreni, për shkollën fill.në Carrallukë;
25. Riparimi i dritave në parkun e qytetit;
26. Furnizimi me barëra për rastet sociale;
27. Furnizimi me material për kanalizimin fekale, përreth përroit në Malishevë;
28. Furnizimi me hemogram për QKMF-në;
29. Ndërtimi i shkollës në Carrallukë;
30. Rregullimi i oborrit të Shtëpisë së Kulturës në Malishevë;
31. Furnizim me zhavorr për rrugët për rrugët lokale në lagjet e fshatrave Balincë dhe Panorc;
32. Rregullimi i sipërfaqes për sallën e sporteve në Carrallukë;
33. Riparimi i objektit të QKMF-së në Malishevë;
34. Riparimi i kulmit të shkollës fillore “Petronini Luarasi” në Llapqevë;
35. Furnizim me ulëse për park;
36. Furnizim me ultrazë QKMF-në;
37. Furnizim me mobile zyre, Shtëpinë e Kulturës;
38. Furnizim me gypa për kanalizimin në Marali;
39. Furnizim me pajisje elektrike qytetin e Malishevës;
40. Furnizim dhe montim i transformatorit në fshatin Bardh;



41. Furnizim me material ndërtimor për familjet e pastrehë;
42. Furnizim me material për fushën e futbollit në SHMPEJ në Kijevë;
43. Furnizim me material për ujësjellës të shkollës fillore “I.Krasniqi”, në Carrallukë;
44. Furnizim me material për kanalizimin e fshatit Drenovc, lagja Dyshekëve;
45. Asfaltimi i rrugës Panorc-Rud;
46. Ujësjellësi në Turjakë;
47. Ujësjellësi në Burim;
48. Ujësjellësi në Lladrovç.

Kryetari Kilaj takoi gazetarët për fundvit

Falënderohen gazetarët për pasqyrimin e ngjarjeve nga Malisheva

Malishevë, 28 dhjetor



Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka pritur sot gazetarët që raportojnë nga Malisheva, të cilët i ka falënderuar për pasqyrimin e ngjarjeve dhe për kontributin e dhënë në informimin e qytetarëve, si dhe ka vlerësuar lartë punën e tyre.

“Kjo më bën të ndihem mirë, pasi konsideroj se janë bërë mjaftë punë të mira në Malishevë, janë kryer dhjetëra projekte gjatë vitit 2011 dhe këto punë janë



prezantuar në media”, ka thënë kryetari Kilaj, duke i falënderuar gazetarët për pasqyrimin e ngjarjeve nga Malisheva.

Më pas, kryetari Kilaj, ka prezantuar projektet e realizuara gjatë vitit 2011, shumica prej të cilave të realizuara nga buxheti i komunës, përderisa nga Qeveria e Kosovës, përkatësisht nga MAPL-ja, janë investuar 40 mijë euro në asfaltimin e rrugës në fshatin Rud dhe 100 mijë euro në rregullimin e shtratit të lumit Mirusha.

“Projektet e realizuara gjatë këtij viti, kanë vlera dekadash, sepse janë projekte të mëdha, si Qendra e Kompetencës, Shtëpia e Kulturës, Palestra Sportive, fusha e futbollit, etj., projekte këto, që kanë qenë ëndërr për Malishevën, ndërsa për vitin e ardhshëm do të ndërtohet edhe muzeu i qytetit, bashkë me sahat kullën, dhe kjo do ti jep Malishevës, përfundimisht pamjen e një qyteti”, tha mes tjerash kryetari Kilaj. “Ndërtimi i parkut të gjelbër i financuar nga BE-ja dhe komuna, si dhe nënkalimi në Astrazup, i financuar nga USAID dhe komuna, janë dy projektet që vlerësohen si investimet më të rëndësishme dhe më të qëlluar në vend, nga këta dy donator gjatë vitit 2011, por edhe nga ne si komunë”, ka vazhduar më tej z. Kilaj, duke premtuar se viti 2012 do të jetë vit i përfundimit të të gjitha rrjeteve të kanalizimeve në të gjitha fshatrat e komunës së Malishevës.

Ndërsa duke folur për investimet në infrastrukturë shkollore, të cilat nuk kanë munguar as këtë vit nga buxheti i komunës dhe donator tjerë, i ka quajtur “spekulime deklarimet e disa partive politike, se Malisheva ka më shumë buxhet për shkolla, se Prishtina, pasi përjashtuar objektin e shkollës në Banjë, projekt i nisur nga MASHTK-ja, asnjë investim tjetër nuk ka për komunën e Malishevës”, tha Kilaj.

Me këtë rast, gazetarëve u ka premtuar zyre për punë, pasi të përfundoj objekti i ri komunës, e poashtu ka premtuar zyre edhe për deputetët të Kuvendit të Kosovës nga Malisheva.

Në fund Kilaj, është përgjigjur edhe në pyetjet e gazetarëve, për çështje të caktuar në interes të tyre.

DKRS shpalli më të mirët për vitin 2011

Malishevë, 29 dhjetor

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS), ka mbajtur sot ceremoninë tradicionale të ndarjes së çmimeve për më të mirët në sektorin e kulturës, rinisë, dhe sportit, të cilëve u janë ndarë mirënjohje dhe çmime nga kjo drejtori.

Hapjen e këtij aktiviteti e bëri drejtori i DKRS-së, z.Mevludin Mazreku, i cili në mënyrë kronologjike, paraqiti aktivitetet e kësaj drejtorie. “E arritur më e madhe e këtij viti, është përfundimi i Shtëpisë së Kulturës në Malishevë dhe ndërtimi i Fushës së Futbollit të madh”, tha mes tjerash drejtori Mazreku.



Më pas, janë prezantuar edhe më të mirët për këtë vit, në bazë të aktiviteteve dhe rezultateve të regjistruara.

Kulturë: Rapsodi i vitit-Ramadan Krasniqi, Letërsi-SHKL “Tafil Kelmendi”, Muzikë-SHKA “Salih e Feriz Krasniqi”, Valle-Grupi i valleve “Shqiponjat” dhe Pikturë-Agron Kastrati.

Rini: Qendra e Rinisë

Lexuesit më të dalluar: Besmire Javori, Fortesa Gashi, Elidona Hoxha, Adelina Hoti, Vjollca Sertolli, Alda Hoxha, Ertugela Tredhaku dhe Besmir Krasniqi.

Sport- Atletikë: Ardian Begaj, Hendboll:Florentinë Gashi, Futbollistja: Almira Krasniqi, Futbollisti: Albrim Hoti, Futboll-Golashënuesi: Edonis Krasniqi, Shah: Amrush Hoti, Not: Albrim Shurdhaj, Klubi: KN “Besa”, Trajneri: Veton Telaku(KN “Besa”), Karate: Agron Zogaj, Veteran i sportit: Milaim Shala.



Sportisti i vitit, u shpall Florijan Begaj, futbollist dhe atlet-anëtar i reprezentacionit të Kosovës në Atletikë, i cili ka fituar 12 medalje të arta, 2 të argjendta dhe 1 të bronzte (15 medalje).

U mbajt mbledhja e XXII-të e Kuvendit të Komunës

Malishevë, 30 dhjetor

Kuvendi Komunal i Malishevës, sot ka mbajtur mbledhjen e njëzetedytë të radhës dhe të fundit për vitin 2011, në të cilën janë marrë dy vendime dhe janë njoftuar anëtarët e kuvendit, nga ana e Kryetarit të Komunës, z.Isni Kilaj, për formimin e Komitetit të Auditimit.



Kryetari Kilaj, i ka njoftuar këshilltarët komunal, për marrjen e vendimit për formimin e Komitetit të Auditimit, e drejtë ligjore e tij. “Kriteret janë të përcaktuara me rregullore dhe anëtarët e këtij komiteti duhet të jenë ekspert” ka thënë Kilaj, përderisa ka propozuar që edhe pozita të caktoj një person/ekspert nga radhët e saj në këtë fushë.

Kuvendi i Komunës, sot shqyrtoi dhe mori edhe vendimin për ndryshimin e rregullores mbi ngarkesat, tarifatat dhe gjobat komunale (rregullorja nr.02/79).

Ndërsa një vendim tjetër i aprovuar me shumicë votash, ishte pajisja me Lap-top, për anëtarët e Kuvendit të Komunës.